

**Vendim nr. 109 datë 20.05.2024**

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, i përbërë nga:

Holta Zaçaj, Kryetare  
Marsida Xhaferllari, Anëtare  
Marjana Semini, Anëtare

në datën 20.05.2024 mori në shqyrtim paraprak kërkesën nr. 5 (N) 2024 të Regjistrimit Themeltar, që i përket:

**KËRKUES:** NORIS ZENELAJ

**OBJEKTI:** Shfuqizimi i vendimit nr. 00-2023-5651 (417), datë 05.12.2023 të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë (dhomë këshillimi), si i papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë dhe Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut. Dërgimi i çështjes për rigjykim në Gjykatën e Lartë.

**BAZA LIGJORE:** Nenet 4, 15, 16, pika 2, 18, 41, 42, 49, 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pika 1, shkronja “i”, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë (*Kushtetuta*); neni 6 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (*KEDNJ*); ligji nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar (*ligji nr. 8577/2000*).

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese (*Kolegji*), pasi dëgjoi relatorin e çështjes Marjana Semini, shqyrtoi kërkesën, dokumentet shoqëruese, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

**V Ë R E N:**

## I

### Rrethanat e çështjes

1. Kërkuesi Noris Zenelaj në datën 11.02.2011 ka filluar marrëdhënien e punës me kontratë 3-mujore në detyrën e inspektor-juristit në drejtorinë e inspektimit juridik në Inspektoratin Kombëtar të Mbrojtjes së Territorit (IKMT). Kërkuesi në datën 11.05.2011 është emëruar në këtë detyrë, pa afat të caktuar. Në datën 01.03.2013 ai është transferuar në detyrën e përgjegjësit në sektorin e kontrollit të territorit. Kryeinspektori i IKMT-së, me shkresën nr. 4382 prot., datë 09.09.2014, ka urdhëruar lirimin nga detyra të kërkuesit.

2. Ndërkohë, Kuvendi në datën 30.05.2013 ka miratuar ligjin nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil” (ligji nr. 152/2013), i cili parashikonte datën 1 tetor 2013 si momentin e hyrjes në fuqi (neni 72). Me hyrjen në fuqi të ligjit u shfuqizua ligji nr. 8549, datë 11.11.1999 “Statusi i nëpunësit civil” dhe çdo dispozitë tjetër që ishte në kundërshtim me të (neni 70). Gjatë kohës që pritej hyrja në fuqi e ligjit, Këshilli i Ministrave ka miratuar aktin normativ nr. 5, datë 30.09.2013 “Për disa ndryshime në ligjin nr.152/2013 “Për nëpunësin civil””, me qëllim shtyrjen në kohë të efekteve të ligjit nr. 152/2013. Akti normativ ka hyrë në fuqi menjëherë dhe është miratuar nga Kuvendi me ligjin nr. 161/2013, datë 17.10.2013. Këto dy akte janë shfuqizuar nga Gjykata Kushtetuese (Gjykata) me vendimin nr. 5, datë 05.02.2014 (vendimi nr. 5/2014), i cili ka hyrë në fuqi në ditën e botimit në Fletoren Zyrtare nr. 18, datë 26.02.2014.

3. Kërkuesi në datën 16.09.2014 i është drejtuar me padi Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, duke pretenduar se ishte liruar nga detyra në kundërshtim me ligjin nr. 152/2013.

4. Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë, me vendimin nr. 7504, datë 18.12.2014, ka vendosur rrëzimin e padisë, pasi kërkuesi nuk mund të konsiderohej nëpunës civil dhe se ligji nr. 152/2013 nuk ishte i zbatueshëm për zgjidhjen e mosmarrëveshjes, por Kodi i Punës.

5. Mbi ankimin e kërkuesit, Gjykata Administrative e Apelit, me vendimin nr. 354 (86-2017-297), datë 02.02.2017, ka vendosur ndryshimin e vendimit nr. 7504, datë 18.12.2014 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë dhe pranimin e pjesës së padisë. Gjykata Administrative e Apelit ka detyruar IKMT-në t’i paguajë kërkuesit 12 paga mujore për zgjidhjen e marrëdhënies së punës në mënyrë të menjëhershme për shkaqe të pajustificuara, 2 paga mujore për mosrespektimin e procedurës sipas përcaktimeve të nenit 144 të Kodit të Punës, 2 paga mujore për mosrespektimin e afatit të njoftimit sipas nenit 143 të Kodit të Punës

dhe 1.5 paga mujore shpërblim për vjetërsi në punë, si dhe vendosi rrëzimin e padisë në lidhje me kërkimet e tjera si të pabazuara në ligj.

6. Kundër vendimit nr. 354 (86-2017-297), datë 02.02.2017 të Gjykatës Administrative të Apelit ka ushtruar rekurs kërkuesi. Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 00-2023-5651 (417), datë 05.12.2023, ka vendosur prishjen e vendimit nr. 354 (86-2017-297), datë 02.02.2017 të Gjykatës Administrative të Apelit dhe lënien në fuqi të vendimit nr. 7504, datë 18.12.2014 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.

7. Kërkuesi në datën 04.04.2024 i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese (*Gjykata*) me ankim kushtetues individual, duke kërkuar shfuqizimin e vendimit të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë.

## II

### Pretendimet e kërkuesit

8. **Kërkuesi**, në mënyrë të përmbledhur, ka pretenduar se gjatë gjykimit të çështjes në Gjykatën e Lartë është cenuar:

8.1. *E drejta për proces të rregullt ligjor në drejtim të standardit të arsytimit të vendimit gjyqësor*, pasi Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë ka zhvilluar gjykimin në dhomën e këshillimit, pa prezencën e palëve, ndërkohë që në gjykim janë vënë në diskutim çështje që duhet të diskutoheshin në prani të palëve. Kjo formë gjykimi është në kundërshtim me nenin 17 të Kushtetutës, pasi kufizimi i të drejtave vendoset vetëm me ligj. Gjykata e mbështet vendimin e saj vetëm në shpjegimet dhe dokumentet e sjella nga palët, të cilat debatojnë sipas parimit të kontradiktoritetit.

8.2. *Parimi i mosdiskriminimit dhe barazisë përpara ligjit, sipas nenit 18 të Kushtetutës*, pasi Gjykata e Lartë për çështje të njëjta ka mbajtur qëndrime të ndryshme. Në një rast edhe Gjykata ka vendosur prishjen e vendimit të Gjykatës së Lartë dhe kthimin e çështjes për gjykim.

8.3. *E drejta e punës*, pasi Gjykata e Lartë ka marrë në shqyrtim pretendime, që nuk ishin ngritur fare në rekurs. Akti administrativ që ka mohuar të drejtën e punës është absolutisht i pavlefshëm, fakt i pranuar nga gjykatat më të ulëta. Argumenti i gjykatave se marrëdhënia e punës rregullohet me Kodin e Punës dhe jo me ligjin nr. 152/2013 është i pabazuar, pasi me vendimin nr. 142, datë 12.03.2014 të

Këshillit të Ministrave është vendosur që marrëdhëniet e punës në IKMT janë pjesë e statusit të nëpunësit civil.

### III

#### Vlerësimi i Kolegjit

##### A. Për legjitimimin e kërkuarit

9. Çështja e legjitimitit (*locus standi*) është një ndër aspektet kryesore që lidhet me nisjen e një procesi kushtetues. Individit, sipas neneve 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pikat 1, shkronja “i” dhe 2, të Kushtetutës, si dhe nenit 71 të ligjit nr. 8577/2000 mund të vërë në lëvizje Gjykatën për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo akti të pushtetit publik ose vendimi gjyqësor, që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë.

10. Ankimi kushtetues individual, në çdo rast, duhet të plotësojë kriteret e nenit 71/a të ligjit nr. 8577/2000, që lidhen me afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat negative të pësuar në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale, shterimin e mjeteve juridike efektive, mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur, si dhe rregullimet e veçanta ligjore të shqyrtimit paraprak të kërkesës. Këto kritere paraprake të pranueshmërisë së kërkesës janë të natyrës kumulative, në kuptimin që ato duhet të plotësohen njëkohësisht. Në këtë vështrim, mjafton mosplotësimi i njërit prej tyre që individit të mos legjitimohet për vënien në lëvizje të gjyimit kushtetues. Në mbështetje të këtij kuadri kushtetues do të vlerësohet legjitimimi i kërkuarit, duke analizuar me radhë kriteret e pranueshmërisë së kërkesës.

11. Në lidhje me legjitimimin *ratione personae*, Kolegji vlerëson se kërkuari, si individ, legjitimohet në kuptim të neneve 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pika 1, shkronja “i”, të Kushtetutës, sepse ka qenë palë në procesin gjyqësor në të cilin janë dhënë vendimet objekt kundërshtimi në Gjykatë dhe ka interes të drejtpërdrejtë në çështjen e parashtruar.

12. Lidhur me kriterin e *shterimit të mjeteve juridike efektive*, sipas neneve 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pika 1, shkronja “i”, të Kushtetutës, Kolegji vëren se kërkuari i është drejtuar Gjykatës duke kundërshtuar vendimin e Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë, për rrjedhojë ai ka shteruar mjetet juridike efektive në dispozicion, sepse nuk ka mjete të tjera veç ankimit kushtetues individual.

13. Lidhur me legjitimimin *ratione temporis*, neni 71/a, pika 1, shkronja “b”, i ligjit nr. 8577/2000 ka parashikuar afatin ligjor 4-mujor nga konstatimi i cenimit për paraqitjen e ankimit kushtetues individual. Gjykata në jurisprudencën e saj, në rastet e kundërshtimit të

vendimeve gjyqësore, ka llogaritur afatin ligjor 4-mujor, duke filluar nga data e dhënies së vendimit nga gjykata që ka përfunduar procesin gjyqësor, nëse kërkuesi nuk provon në nivel kushtetues se ka marrë dënim në një datë të ndryshme (*shih vendimet nr. 14, datë 21.06.2022; nr. 12, datë 24.05.2022 të Gjykatës Kushtetuese*).

14. Në rastin konkret, Kolegji vëren se vendimi i Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë mban datën 05.12.2023, ndërsa kërkuesi i është drejtuar Gjykatës në datën 04.04.2024, për rrjedhojë ankimi kushtetues individual është paraqitur brenda afatit ligjor 4-mujor të parashikuar nga ligji.

15. Në lidhje me legjitimitimin *ratione materiae*, Kolegji konstaton se kërkuesi ka pretenduar cenimin e parimit të barazisë përpara ligjit dhe mosdiskriminimit, të garantuar në nenin 18 të Kushtetutës, cenimin e standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor, të garantuar në nenin 42 të Kushtetutës, si dhe cenimin e së drejtës së punës, të garantuar në nenin 49 të Kushtetutës.

16. Kolegji konstaton se për pretendimin e cenimit të parimit të barazisë përpara ligjit dhe mosdiskriminimit kërkuesi ka parashtruar se Gjykata e Lartë për çështje të njëjta ka mbajtur qëndrime të ndryshme.

17. Kolegji thekson se nën dritën e parimit kushtetues të barazisë përpara ligjit, të sanksionuar nga neni 18 i Kushtetutës dhe në vijim të jurisprudencës së Gjykatës, barazia përpara ligjit nuk do të thotë që të ketë zgjidhje të njëjtoja për individë ose kategori personash që janë në kushte objektivisht të ndryshme. Kjo presupozon barazinë e individëve që janë në kushte të barabarta. Megjithatë, parimi i barazisë nuk e ndalon trajtimin e diferencuar, por trajtimi i ndryshëm i kategorive të caktuara që përfitojnë nga kjo e drejtë mund të përliqet vetëm në raste përjashtimore dhe për shkaqe të arsyeshme e objektive (*shih vendimet nr. 34, datë 10.04.2017; nr. 60, datë 16.09.2016; nr. 71, datë 27.11.2015 të Gjykatës Kushtetuese*).

18. Në rastin konkret, Kolegji vëren se dy vendimet e paraqitura nga kërkuesi nuk rezultojnë të jenë njësuës për praktikën gjyqësore dhe në kushtet kur kërkuesi nuk ka parashtruar asnjë shkak konkret për diskriminimin e tij, vendimet e referuara nuk përbëjnë argument të mjaftueshëm kushtetues për cenimin e parimit të barazisë përpara ligjit dhe të mosdiskriminimit. Nga ana tjetër, Kolegji evidenton se vendimet gjyqësore janë rrjedhojë e shqyrtimit të pretendimeve dhe provave të ndryshme të paraqitura prej palëve ndërgjyqëse në secilin rast, ndaj vendimmarrjet e lidhura me mosmarrëveshjet e punës të mbështetura, në dukje, në fakte të njëjta, mund të jenë të ndryshme. Për rrjedhojë, Kolegji vlerëson se

argumentet për këtë pretendim nuk janë në nivel kushtetues dhe nuk mund të merren në shqyrtim.

19. Për pretendimin e cenimit të standardit të arsytimit të vendimit gjyqësor dhe të së drejtës për punë, nisur nga thelbi i argumentit, që lidhet me qëndrimin e mbajtur nga Gjykata e Lartë për zgjidhjen e çështjes për largimin nga detyra, Kolegji do t'i analizojë në drejtim të standardit të arsytimit të vendimit gjyqësor.

*B. Për pretendimin e cenimit të standardit të arsytimit të vendimit gjyqësor*

20. Kërkuesi ka pretenduar se Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë e ka zhvilluar gjykimin në dhomën e këshillimit, pa prezencën e palëve, ndërkohë që në gjykim janë vënë në diskutim çështje që duhet të diskutoheshin në prani të palëve. Kjo formë gjykimi është në kundërshtim me nenin 17 të Kushtetutës, pasi kufizimi i të drejtave vendoset vetëm me ligj. Gjykata e mbështet vendimin e saj vetëm në shpjegimet dhe dokumentet e sjella nga palët, të cilat debatojnë sipas parimit të kontradiktoritetit. Gjykata e Lartë ka marrë në shqyrtim pretendime që nuk ishin ngritur fare në rekurs.

21. Gjykata në jurisprudencën e saj ka pohuar se e drejta për proces të rregullt ligjor përfshin edhe të drejtën për të pasur një vendim gjyqësor të arsytuar, që i garantohet individit nga nenet 42 dhe 142, pika 1, të Kushtetutës. Arsytimi i vendimeve është elementi thelbësor i një vendimi të drejtë (*shih vendimet nr. 19, datë 07.07.2022; nr. 2, datë 11.02.2021; nr. 3, datë 20.01.2017 të Gjykatës Kushtetuese*). Vendimet gjyqësore që japin gjykatat e të gjitha niveleve në përfundim të gjykimit përbëjnë aktin procedural kryesor të të gjithë procesit gjyqësor. Në tërësinë e tij ai duhet konsideruar si një unitet, në të cilin pjesët përbërëse janë të lidhura ngushtësisht mes tyre dhe ato duhet të jenë në shërbim dhe funksion të njëra-tjetrës (*shih vendimet nr. 13, datë 21.03.2023; nr. 11, datë 24.05.2022; nr. 16, datë 16.03.2021 të Gjykatës Kushtetuese*).

22. Gjykata pohon se është detyrë e gjykatave të juridiksionit të zakonshëm të vlerësojnë faktet dhe provat e administruara, si dhe të interpretojnë ligjin për qëllim të procesit gjyqësor që ato zhvillojnë, ndërsa detyra e kësaj Gjykate është të shqyrtojë dhe vlerësojë nëse gjatë procesit gjyqësor ka pasur shkelje të të drejtave kushtetuese, si dhe nëse zbatimi i ligjit ka qenë eventualisht arbitrarisht, në kuptimin që të bjerë ndesh haptazi me konceptin e gjykimit të drejtë të përcaktuar në nenin 42 të Kushtetutës (*shih vendimin nr. 33, datë 14.11.2022 të Gjykatës Kushtetuese*).

23. Në çështjen konkrete, Kolegji vëren se pretendimi thelbësor i parashtruar nga kërkuesi lidhet me qëndrimin e mbajtur nga Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, i cili ka vendosur prishjen e vendimit të Gjykatës Administrative të Apelit dhe lënien në fuqi të vendimit të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë. Më konkretisht, bazuar në materialet e dosjes, rezulton se kërkuesi i është drejtuar Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë duke kërkuar shfuqizimin e urdhrit nr. 4382, datë 09.09.2014 të kryeinspektorit të IKMT-së për ndërprerjen e marrëdhënieve të punës, detyrimin e këtij institucioni për ta rikthyer në detyrën që kishte përpara lirimit ose në një detyrë tjetër të të njëjtit nivel, si dhe detyrimin për t'i paguar kërkuesit pagën nga momenti i largimit deri në rikthimin në detyrë, referuar ligjit nr. 152/2013.

24. Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë, me vendimin nr. 7504, datë 18.12.2014, ka vendosur rrëzimin e padisë dhe se ligji i zbatueshëm për zgjidhjen e mosmarrëveshjes ishte Kodi i Punës. Pas ankimit të kërkuesit, Gjykata Administrative e Apelit, me vendimin nr. 354 (86-2017-297), datë 02.02.2017, ka vendosur ndryshimin e vendimit nr. 7504, datë 18.12.2014 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë dhe pranimin e pjeshëm të padisë. Gjykata Administrative e Apelit ka detyruar IKMT-në t'i paguajë kërkuesit 12 paga mujore për zgjidhjen e marrëdhënies së punës në mënyrë të menjëhershme për shkaqe të pajustificuara, 2 paga mujore për mosrespektimin e procedurës sipas përcaktimeve të nenit 144 të Kodit të Punës, 2 paga mujore për mosrespektimin e afatit të njoftimit sipas nenit 143 të Kodit të Punës dhe 1.5 paga mujore shpërblim për vjetërsi në punë dhe ka vendosur rrëzimin e padisë në lidhje me kërkimet e tjera si të pabazuar në ligj. Pas rekursit të ushtruar nga kërkuesi, Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, ka vendosur prishjen e vendimit nr. 354 (86-2017-297), datë 02.02.2017 të Gjykatës Administrative të Apelit dhe lënien në fuqi të vendimit nr. 7504, datë 18.12.2014 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.

25. Kolegji vëren se nga përmbajtja e vendimit të Kolegjit Administrativ i Gjykatës së Lartë ai ka marrë në analizë pretendimet e parashtruar nga kërkuesi, që në thelb lidheshin me zbatimin e ligjit nr. 152/2013 për rregullimin e marrëdhënies së punës së tij. Në vijim, Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë ka vlerësuar se të dyja gjykatat e faktit kanë pranuar se marrëdhënia e punës së paditësit rregullohej nga Kodi i Punës, fakt që nuk është kundërshtuar nga kërkuesi. Të dyja gjykatat kanë vlerësuar se paditësi nuk e ka fituar statusin e nëpunësit civil për sa kohë nuk ka pasur një vendim konfirmimi të këtij statusi nga njësia përgjegjëse (*shih faqen 8 të vendimit të Gjykatës së Lartë*). Kolegji Administrativ ka arsyetuar se Gjykata

Administrative e Apelit gabimisht ka vijuar gjykimin duke e zgjidhur mosmarrëveshjen, bazuar në një shkak tjetër ligjor, referuar Kodit të Punës dhe të papretenduar nga paditësi, në kundërshtim me nenet 5 dhe 16 të Kodit të Procedurës Civile (KPC). Kolegji Administrativ ka vijuar në arsyetim se paditësi ka kërkuar shfuqizimin e aktit për lirim të tij nga detyra dhe Gjykata Administrative e Apelit nuk mund të ndryshonte kryesisht objektin dhe shkakun e padisë së paditësit, pasi kjo është e drejtë ekskluzive e tij në zbatim të neneve 16 dhe 185 të KPC-së dhe nuk rezulton që ai të ketë ngritur pretendime/kërkime për trajtimin e largimit të tij me Kodin e Punës, rrjedhimisht dhe përfitimin e dëmshpërblimeve sipas këtij shkak (shih faqen 10 të vendimit të Gjykatës së Lartë).

26. Në vijim, Kolegji vlerëson se pika kryesore e pretendimit kushtetues të kërkuarit ka të bëjë me mënyrën se si Gjykata e Lartë në vendimin e saj ka interpretuar konceptet ligjore procedurale të objektit dhe shkakut ligjor të padisë, të bazës ligjore të padisë dhe të së drejtës së gjykatës së zakonshme për të bërë me nismën e saj cilësimin ligjor të mosmarrëveshjes që i paraqitet për shqyrtim – të rregulluara nga nenet 5, 31, 154 e 185 të KPC-së dhe vendimi unifikues nr. 3/2012. Duke iu referuar arsyetimit të Gjykatës së Lartë, Kolegji thekson se ajo ka vepruar brenda funksionit të saj kushtetues për interpretimin e ligjit, duke i dhënë përgjigje të argumentuar kërkuarit për pretendimet e tij të parashtruara në rekurs. Arsyetimi i saj, në lidhje me përfundimin e arritur për kërkimin e kërkuarit, nuk rezulton i pamjaftueshëm, ai nuk përmban kundërshtime, kontradiksion të hapur ose të fshehtë dhe as të meta të tilla serioze që të cenojnë standardin kushtetues të vendimit gjyqësor të arsyetuar.

27. Për sa i përket pretendimit të kërkuarit për procedurat e gjyqësorit në dhomën e këshillimit, Kolegji evidenton se shqyrtimi i çështjes në Gjykatën e Lartë, si rregull, bëhet mbi bazën e dokumenteve në dhomën e këshillimit, referuar nenit 482 të KPC-së dhe nenit 49 të ligjit nr. 49/2012 “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, të ndryshuar. Nga ana tjetër, Kolegji vlerëson se forma e gjyqësorit në dhomën e këshillimit, pra jo me pjesëmarrjen e palëve, nuk ndikon në të drejtat e kërkuarit, për sa kohë ai i ka pasur të gjitha mundësitë t’i ushtrojë ato nëpërmjet paraqitjes së rekursit.

28. Në përfundim, Kolegji çmon se kërkesa nuk plotëson kriteret ligjore për kalimin e saj për shqyrtim në seancë plenare.

## **PËR KËTO ARSYE,**

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese, në bazë të neneve 31 dhe 31/a, pikat 1 dhe 2, shkronjat “a” dhe “e”, të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar,

**V E N D O S I:**

Moskalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare.